



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1375 / Prot
5

Tiranë, më 24/12.2014

V E N D I M

Nr. 02 ,datë 24/12 2014

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të procesverbalit të inspektimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 181, datë 24.10.2014, është ushtruar inspektim administrativ pranë subjektit juridik “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Inspektimi ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit, me objekt: “Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit të Komisionerit Nr. 61, datë 30.06.2014, dhënë ndaj kontrolluesit “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Tiranë.

“Shërbimi Kombëtar i Punësimit” është person juridik jopublik, në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas shqyrtimit të procesverbalit të inspektimit administrativ dhe provave të administruara konstaton se, kontrolluesi “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, Tiranë, nuk ka marrë masa për zbatimin e pikës 1 të Rekomandimit nr. 61, datë 30.06.2014, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke mos realizuar detyrimin për publikimin e “politikave të privatësisë”, në faqen e tij në internet (www.shkp.gov.al) në një rubrikë të veçantë dhe duke mos përmbushur kështu detyrimet që rrjedhin nga neni 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, nëpërmjet procesverbalit parashtrori këto pretendime:

“Mungesa e Politikës së Privatësisë, ka ardhur si rezultat i punimit nga ana jonë, në mënyrë të vazhdueshme me sistemin informatik. Në këtë kuptim, duke qenë se ne po bënim përmirësime me kompaninë e kontaktuar për këtë qëllim, punë që u realizua në fillim të Tetorit. Marrim masa menjëherë për realizimin në vijimësi dhe njoftim te ju, edhe sipas marrëveshjes së datës 6 Mars 2014”.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa

më i shpejtë që të jetë e mundur. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të internetit duhet të kryhet sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Publikimi i rubrikës “politikat e privatësisë” ka si qëllim informimin e individëve (subjekte të të dhënave personale) që aplikojnë online ose personave që vizitojnë këtë faqe, mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, si dhe masat e marra për sigurinë e të dhënave personale. Në këtë rubrikë duhet të publikohen të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. “Politikat e privatësisë” synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.

Komisioneri vlerëson rëndësinë e respektimit të parimit të transparencës në përpunimin e informacionit të subjekteve të të dhënave në mënyrë që këta të fundit të kenë dijeni mbi: personat që njihen me të dhënat e tyre, qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave, kujt do t’i përhapen të dhënat, mbrojtjen e privatësisë. Për këtë arsye çdo individ/subjekt i të dhënave personale ka të drejtën e mbrojtjes së duhur të të dhënave të tij personale. Përpunimi i të dhënave personale duhet të lejohet për aq sa është i nevojshëm, i drejtë, i ligjshëm dhe proporcional.

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i inspektimit administrativ, si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me datë 03.12.2014 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit administrativ. Në këtë seancë dëgjimore u paraqitën përfaqësuesit e kontrolluesit dhe u administruan pretendimet me shkrim.

Pretendimet konsistojnë në:

- *Kontrolluesi disponon dy web-site, (www.shkp.gov.al dhe www.puna.gov.al). www.shkp.gov.al është web-site që përmban një informim të përgjithshëm të shërbimeve që ofron Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe nuk përmban baza të dhënash personale të Bankave të punëkërkuësve apo të punëdhënësve.*
- *Shërbimi Kombëtar i Punësimit, për shkak të vonësave në procedurat e prokurimit publik e ka patur të pamundur realizimin në kohë të detyrës së rekomanduar nga Komisioneri, por thekson se politikat e privatësisë ju shtuan web-sitit me rastin më të parë i cili daton me fillimin e procesit të mirëmbajtjes.*
- *Kontrolluesi, referuar Rekomandimit nr. 61, datë 30.06.2014, gjithashtu pretendon se nuk ndodhet para kushteve të nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, pasi shkelja nuk është e qëllimshme, nuk është e përsëritur dhe nuk ka raste të përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të Komisionerit nga ana e “Shërbimit Kombëtar i Punësimit”.*

Komisioneri vlerëson se në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes/web-sitit në internet, ka detyrimin që të publikojë në faqe/web-sitin në internet “politikat e privatësisë”, pasi kontakti

paraparak i çdo subjekti të dhënash (të dhënat e të cilëve përpunohen nga kontrolluesi) ose personi tjetër realizohet nëpërmjet faqes/web-sitit në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “politikave të privatësisë” në faqen/web-sitin në internet përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, që konsiston në informimin e çdo personi që viziton faqen (subjekt i të dhënave personale ose jo), mbi mënyrat e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale si dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Komisioneri vlerëson se vonesat në procedurat e prokurimit nuk përbëjnë shkak për mospërbushjen e detyrimit ligjor i cili në mënyrë taksative ka patur një afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh për t’u përmbushur (parashikuar në Rekomandimin nr. 61, datë 30.06.2014, të Komisionerit). Gjithashtu kontrolluesi “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, nga momenti i marrjes dijeni të rekomandimit, nuk është angazhuar për të informuar Zyrën e Komisionerit lidhur me pengesat e mundshme për përmbushjen e detyrimit dhe nuk ka kërkuar asistencën e Komisionerit lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi.

Mospublikimi i “politikave të privatësisë” në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV “Të drejtat e subjektit të të dhënave”, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cenuar rëndë ato.

Kontrolluesi nuk ka reaguar menjëherë pas inspektimit të kryer për verifikimin e zbatimit të Rekomandimit nr. 61, datë 30.06.2014, të Komisionerit. Kjo vërtetohet nga fakti se nga kontrolli i vazhdueshëm i faqes (pas inspektimit) rezultoi se deri në datën 10.11.2014 kontrolluesi nuk kishte reaguar duke mos e përfshirë në faqen zyrtare rubrikën mbi “Politikat e Privatësisë”. Më pas, përfaqësuesi i kontrolluesit informoi për përmbushjen e detyrimit duke vënë në dispozicion edhe përmbajtjen e “Politikave të Privatësisë” të publikuara në faqen zyrtare në internet. Nga kontrolli i fundit i faqes rezulton se “Politikat e Privatësisë” janë publikuar në një rubrikë të veçantë.

Komisioneri e vlerëson reagimin e kontrolluesit edhe pse ky reagim ka ardhur pas realizimit të inspektimit administrativ.

Komisioneri, duke patur parasysh faktet e mësipërme, moszbatimin e detyrimit për informim nga ana e kontrolluesit (bazuar në nenin 18 të ligjit), dhe moszbatimin e Rekomandimit nr. 61, datë 30.06.2014, vlerëson se ndodhemi në kushtet e shkeljes serioze të ligjit pasi mos informimi i subjekteve të të dhënave, cënon rëndë ushtrimin e të drejtave të tyre (parashikuar në kreun IV të Ligjit), dhe kjo shkelje përbën kundërvajtje administrative.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se në përfundim të inspektimit administrativ, moszbatimi i Rekomandimit nr. 61, datë 30.06.2014 të Komisionerit, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39/1/b të ligjit nr. 9887

datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10 000 deri në 300 000 lekë. Në pikën 2 të nenit 39 është parashikuar se: "Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni".

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për informim si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit, mosrespektimin e afatit kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh për përmbushjen e detyrimit, masat reaguese të kontrolluesit dhe seriozitetin e zbatimit të detyrave që dalin nga Rekomandimi i Komisionerit pas lënies së proces-verbalit nga grupi i inspektimit, faktin që kontrolluesi ka qenë serioz dhe bashkëpunues gjatë ushtrimit të këtij inspektimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 29, 30/2, 32, 39/1/b, 39/2, 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë":

V E N D O S A

1. Dënimin e kontrolluesit "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njofimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

